

[type nere]

KONTRATË SHITBLERJE

(Kuotash në Kapitalin Themeltar)

Sot, më datë 06.06.2023 (dymijë e njezete e tre) në Tiranë.

1- SHITËS: **1. Giovanni Brancale** shtetas **Giovanni Brancale** madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me Karte identiteti nr.CA65504CN, lindur ne Bari (BA) Itali, me 07.07.1975 dhe banues ne S.Da Lama Del Duca (Ceglie). 9 Bari (BA) Itali.

BLERËS: **1. Giuseppe Partipilo** shtetas Italian. lindur në Bari, Itali, i datëlindjes 05.11.1952, banues në Bari, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës e dokumentit identifikues ID me Nr:CA18433AN.

Palët, me dëshirën dhe vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavarura, pasi kanë zhvilluar bisedime paraprake, në mbështetje të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë: Kodit Civil, Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, dhe Statutin e Shoqërisë "Global Services & Consulting" SHPK, kanë dakord të lidhin këtë Kontratë Shitblerjesh Kuotash me përmbajtjen si vijon:

1. TË DHËNA PARAPRAKE

1.1 Shitësit **Giovanni Brancale**, është pronare e **1 (një) Kuote**, që përfaqëson **25%** (njezete e pese përqind) të kapitalit themeltar të regjistruar të Shoqërisë "**Global Services & Consulting**" SHPK" sh.p.k. shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar si person juridik në Republikën e Shqipërisë pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), me numër unik identifikimi NIPT (NIUS) M31716025L, dhe seli në adresën: Njesia Farke, Selite, Rruga Reli, Nr.1, kati 0, hyrja 2, Tirane 1060.


2. OBJEKTI

2.1 Kjo Kontratë ka për objekt kalimin e pronësisë nga Shitësit tek Blerësit, mbi kuotat e kapitalit themeltar të regjistruar të Shoqërisë "**Global Services & Consulting**" SHPK

2.2 Pronësia nga Shitësit tek Blerësit mbi kuotat e kapitalit themeltar të regjistruar të Shoqërisë "**Global Services & Consulting**" SHPK transferohet në këtë mënyrë:

2.2.1 Shitësi **Giovanni Brancale** i shetë z.**Giuseppe Partipilo** **1 (një) Kuote** ne pronesi te tij, që përfaqëson **25%** (tneqin përqind) të kapitalit themeltar të regjistruar të Shoqërisë "**Global Services & Consulting**" SHPK.

3. ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS SË TIJ



[type here]

3.1 Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kuotave të kapitalit të Shoqërisë, të jetë sipas vlerës së tyre nominale.

3.2 Shitësit deklarojnë se vlera e kuotave të nënshkuara objekt Kontrate nuk është shlyer në llogarinë e Shoqërisë, për këtë arsye likuidimi i kuotave të shitura do të behet me vonë në llogarinë e shoqërisë.

3.3 Blerësi **Giuseppe Partipilo** shtetas Italian, lindur në Bari , i datëlindjes 05.11.1952, banues në Bari, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës e dokumentit identifikues ID me Nr:CA18433AN do të shlyej me vonë në llogarinë e shoqërisë çmimin e një Kuote në pronësi të tij, që përbën **25%** (njetete e pese për qind) të kapitalit themeltar të regjistruar të Shoqërisë **"Global Services & Consulting" SHPK**, në vlerën 300 000 (treqind mije) leke.

4. MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

4.1 Pronësia mbi kuotat e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë **"Global Services & Consulting" SHPK** do të kalojë nga pala shitëse, tek pala blerëse, në momentin e depozitimit të kësaj Kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë.

4.2 Pala Shitëse dhe Pala Blerëse përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas Pikës 3.1.

4.3 Nga momenti i depozitimit të Kontratës në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi Kuotat e kapitalit të transferuar, dhe këto të drejta fitohen nga blerësit, me strukturën e pjesëve si vijon:

Ortakët e Shoqërisë	Pjesët e Zotëruara	Përqindja e Kapitalit	Vlera e kapitalit
Giuseppe Partipilo	1	25	300 000 leke
Francesco Carlucci	1	25	300 000 leke
Antonio Labriola	1	25	300 000 leke
Franca Buccomino	1	25	300 000 leke
TOTALI		100 %	1 200 000 leke

5. DETYRIMET E SHITËSIT

5.1 Pala shitëse detyrohet:

- T'i kalojë palës blerëse pronësinë mbi kuotat objekt i kësaj kontrate të lirë nga çdo barrë, sekuestrim dhe detyrime të çfarëdolloj natyre.

Tople gar -

[Type here]

- T'i dorëzojë palës blerëse dokumentacionin mbi pronësisë e kuotave që i shet nëpërmjet kësaj kontrate.
- Të paguajë shpenzimet e regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

6. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

6.1 Për këtë Kontratë, do të jenë bazë për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë,
- Legjislacioni që rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë:


6.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj Kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre, në rast të kundërt organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. DISPOZITA TË FUNDIT

7.1 Kontrata u përpilua në 4 (kater) kopje me fuqi të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe, nga një kopje ju jepet palëve, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), dhe një kopje duhet të depozitohet në selinë e Shoqërisë.

PALËT

SHITËS

Giovanni Brancale




BLERËS

Giuseppe Partipilo
